



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **142**

Prishtinë, më 25.3.2014, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Faton Topalli, Rasim Demiri, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina, Ramiz Lladrovci, Nijazi Idrizi.
Mungoi : Boban Todorović.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 18.3.2014,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma,
4. Konfirmimi për leximin e dytë për dy projektligje (regjistrimi i bujqësisë dhe shitja e banesave),
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 18.3.2014

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 18 mars 2014.

3. Shqyrtimi i projektligjit për mbrojtjen nga zhurma

Kryetari Nait Hasani përshëndeti mysafiren **Sanja Popoviq** nga OSCE dhe me pajtimin e Komisionit u shqyrtuan shkurtimisht vërejtjet nga OSCE (edhe pse që janë me vonesë-fakt ky që u pranua edhe nga mysafirja me kërkim falje) pasi që kjo organizatë është bashkëpunues dhe mbështetës vite ma radhë i Kuvendit të Kosovës. **Ramiz Lladrovci** konfirmoi pajtimin e tij edhe pse shpesh ndodhë që vërejtjet nga OSCE dhe BE vinë me vonesë dhe përfshijnë gjysmën e projektligjit, siç është rasti me këtë për zhurmën, njëherit insistoi të mos veprohet politikisht me këtë ligj. **Salih Morina** gjithashtu ishte për bashkëpunim me OSCE për këtë projekt por shqyrtimi të shtyhet për një javë kur do të shihet a ka vend për inkorporim të vërejtjeve, pajtimin ishte edhe **Sevdije Lama**, **Faton Topalli**, **Rasim Demiri**, **Afërdita Berisha**. Edhe pse shumica kërkuan shqyrtimin njëjavorë për mbledhjen e radhës, kryetari **Nait Hasani** i lejoi mysafires të prononcohet shkurtimisht çka janë vërejtjet e tyre kryesisht, e cila potencoi se ky ligj duhet të jetë e harmonizuar me disa ligje tjera në Kosovë, sidomos ato të zonave të veçanta, mirëpo reagimi i shumicës së anëtarëve të komisionit ishte që ky ligj do të jetë për qytetarët e Kosovës e jo për zonat e veçanta. Në rast se ka praktika evropiane, vazhdoi kryetari, të cilat duhet të inkorporohen, edhe ky komision do ti përfillojë ato për këtë ligj.

Ylber Sherifi, zyrtar i lartë i fushës, potencoi se ky Ligj është në përputhshmëri me Direktivën e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës mjedisore (Direktiva nr.2002/49/EC) dhe se vërejtjet e OSBE-së nuk kanë të bëjnë me këtë. Ndërsa sa i përket referimit të Ligjit për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, nuk është e nevojshme sepse vetëm bëhet duplikimi i panevojshëm. Përmendi aktivitetet e ndaluara dhe të kufizuara brenda zonave të veçanta të mbrojtura nga neni 5 dhe 6 i Ligjit për Zonat e Veçanta të mbrojtura përmes të cilave këto zona janë të mbrojtura nga shumë aktivitete edhe nga zhurma mjedisore.

Në vazhdim përfaqësuesja e OSCE filloi sqarimin një nga një të vërejtjeve të tyre, siç janë Neni 2.1, Neni 6 (3.2), Neni 14, Neni 15.3 dhe 15.4, Neni 28, Neni 29 (gjohet), Neni 24.2, Neni 12.5, Neni 11 (qysh formohet ky komision), Neni 7 të fshihet, Neni 6, Neni 5 të fshihet etj, mirëpo kryetari **Nait Hasani** (edhe pse **Nijazi Idrizi** sugjeroi që OSCE deri javën tjetër të risqarojë vërejtjet) në pajtim me shumicën e anëtarëve konstatoi se : lidhur me vërejtjet e OSCE përfaqësuesja nuk ka nevojë të prezantoi në mbledhjet e radhës dhe falënderoi për bashkëpunim, ngase siç tha, brengat e kësaj organizate për zonat e veçanta (për shumicën e vërejtjeve) nuk kanë nevojë të ekzistojnë, ngase ky Ligj bëhet për gjithë qytetarët e Kosovës pa dallim, me këto vërejtje projektligji do të ngarkohet me duplikime të panevojshme, përfundoi.

Ramiz Lladrovci shfrytëzoi rastin që ta ftoi përfaqësuesen e OSCE për takimin e GP të premtën, pasi që edhe për projektin e Obiliqit kanë bërë vërejtje me shkrim.

4. Konfirmimet për leximin e dytë

Kryetari Nait Hasani konstatoi se **Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore, përcjellët për leximin e dytë** për mbledhjen plenare të së enjtes, ndërkaq **Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Regjistrimin e Bujqësisë**, përkundër faktit se ka përfunduar me procedimin në të gjitha komisionet parlamentare, mbetet për javën tjetër, ngase zyrtarët e MB duhet të rishikojnë bashkë me donatorët mundësinë e shtyrjes së regjistrimit të bujqësisë për vitin 2015, për shkak të zgjedhjeve nacionale të sivjetme, nëse jo atëherë mbetet opsioni i sugjeruar nga takimi i Komitetit drejtues për datën 1 deri 20 nëntor të bëhet regjistrimi i bujqësisë. **Ramiz Lladrovci** potencoi që kjo mos të ndodhë më rreth ndryshimit të datave, ngase kush e din sot kur do të mbahen zgjedhjet. **Nijazi Idrizi** ishte i mendimit se njësoj do të bëhet si në vitin e kaluar kur ishin edhe zgjedhjet lokale edhe regjistrimi i bujqësisë, ndaj njëra u deshtë të shtyhet (RB), prandaj ky fakt duhet të mirët parasysht. **Nait Hasani**, **Salih Morina**, **Afërdita Berisha**, **Faton**

Topalli u pajtuan për vitin 2015 por të pyeten kompetentët edhe një herë dhe të sjellët përgjigja për mbledhjen e radhës. **Shefki Zeqiri dhe Bajrush Qevani** nga MB përkatësisht Agjencia përkatëse, theksuan se janë zbrazëtirat ligjore të cilat duhet të eliminohen por edhe të pyeten donatorët, të cilët garantojnë se regjistrimi do të kryhet në afatin e cekur në Komitetin drejtues. Në pyetjen e **Afërdita Berishës** pse nuk bën viti 2015, përgjigja ishte se rrezikohet mbështetja e donatorëve, të cilët duhet të marin konfirmimet nga shtetet e tyre.

5. Të ndryshme

Në pikën të ndryshme u potencuan disa shqetësime (kërkesa) të cilat deri tani nuk janë realizuar ose janë realizuar me mangësi :

- **Sevdije Lama** pyeti pse nuk ka raportuar MMPH rreth lumenjve, dhe
- pse nuk kemi ende përgjegje nga MMPH sa arçitekt dhe ndërtimtar janë licencuar,
- **Nait Hasani** njoftoi se Agjencia e pyjeve me rastin e pyetjeve të parashtruara ka dhënë vetëm përgjigje politike, sidomos rreth dhënjes me qira të pronave për antena publike,
- **Afërdita Berisha** i bashkëngjitet GP-së për infrastrukturë mjedisore.

Mbledhja përfundoi në orën 13,10.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani